

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

V E N D I M


1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **1000 (njëmijë euro)** për Abdullah Berisha, për shërimin e sëmundjes. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqnie Sociale.
2. Mjetet derdhen në xhirollogarinë e Abdullah Berisha me [REDACTED]
3. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim e përfituesit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dorëzohet

- Palëve,
- DSHMS, dhe
- Arkivit.

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

Komunës së Gjilanit, si autoritet publik

dhe

Abdullah Berisha, përfitues

Gjilan, 2023

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare për Abdullah Berisha nga Gjilani, për mbulimin e një pjesë të shpenzimeve të shërimin, sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren 01. nr. 016-126422 dt. 29.12.2016 e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/208,01 nr. 016-28468 dt. 22.03.2018 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve (neni 22 paragrafi 1.8)

Neni 2
Vlera e Subvencionimit

1. Vlera e subvencionimit është shuma prej 1000 € (njëmijë euro) dhe ndahet nga Kodi Buxhetor – Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale.
2. Kjo është shuma e vetme dhe përfundimtare që paguhet nga Komuna e Gjilanit për përfituesin.

Neni 3
Obligimet e palëve

1. Obligimet e përfituesve të subvencionit janë :
 - 1.1. mjetet e marra, përfituesit do t'i shfrytëzojnë vetëm për qëllimet e paraqitura në Kërkesë.
 - 1.2. përfituesit duhet të raportojnë tek Komuna e Gjilanit brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.
2. Përfituesit duhet të sjellin tek Komuna e Gjilanit:
 - 2.1. raportin narrativ (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje).
 - 2.2. njofton Komunën e Gjilanit për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit.

Neni 4

1. Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:
 - 1.1. obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje, t'ia transferoj në xhirollogarinë bankare të përfituesit, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2. bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

Neni 5
Afatet kohore

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.

2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6
Shkëputja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:

- 1.1. tejkalimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
- 1.2. marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët në marrëveshje;
- 1.3. shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
- 1.4. mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive.

Neni 7
Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të paraparë me projekt, përfituesit janë të obliguar t'i kthejnë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

Neni 10
Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta për secilën palë.



Abdullah Berisha